



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



Shkresë	13.04.2023
Nga:	ZPP GEZIM HAJDINI
PER:	Alhena Law Office "L.L.C" & Kushtrim Bytyqi
Lënda :	VENDIM

Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik nr 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr 05/L-068 dhe ligjin nr 05/L-92 Ligji mbi Prokurimin publik në Kosovë, përkatësisht neni 108/A pika 2 dhe neni 6 pika 1 e Rregullave për parashtrimin e kërkesave për Rishqyrtim për Vendim të Autoritetit Kontraktues, Zyra e Prokurimit në Drenas nxjerr:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Alhena Law Office " L.L.C." & Kushtrim Bytyqi B.I" kundër vendimit të autoritetit kontraktues "Shërbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunës së Drenasit" me nr 611-23-1507-2-1-1.

OE ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të AK me datën 12.04.2023 kundër vendimit të AK me disa pretendime të cilat janë të pabazuara, dhe jo të drejta.

Autoriteti Kontraktues njofton operatorin në fjalë së të gjitha ofertat janë trajtuar në mënyrë të barabartë, dhe pa diskriminim duke u bazuar në ligjet në fuqi të Kosovës.

Zyra e Prokurimit ka rishikuar edhe njëherë ofertën tuaj, dhe konkludon se ju jeni si operator i papërgjegjshëm për arsye se oferta juaj është në kundërshtim me Rregulloren për Tarifatat e Avokatëve, ndërsa sa për informimin tuaj, Autoriteti ka të drejtë të përdorë të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi të RKS për vlerësimin e drejtë të tenderëve. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit nr.04/L-193 për Avokatinë, thotë "Avokati ka të drejtë për pagesën e honorarit dhe

kompensimin e shpenzimeve për punën e tij në pajtim me Rregulloren për tarifën e avokatëve. Pra, çështja e tarifave për avokatët është çështje e cila e ka bazën në ligj. E në pajtim me ligjin e cekur me lartë, Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës, me datë 18 Mars 2027 ka nxjerr Rregulloren për tarifat e avokatëve e cila rregullon pagesat për tarifat për punën e avokatëve dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve.

Në rrjedh të kësaj për sa i përket çështjes së shërbimeve të kërkuara, sipas shpalljes publike të datës 07.04.2023, vlera e kompensimeve për pozicionet përkatëse të shpalljes është e vendosur konform shtojcave përkatësisht numrit 6 dhe numrit 7 tarifar të Rregullores së lartpërmendur.

Vendosja ndryshe nga që ka vendosur komuna e Drenasit si autoritet kontraktues, do të nënkuptonte shmangien, përkatësisht shkeljen e një rregullore cila është nxjerrë nga organi i autorizuar me Ligj (Kuvendi i Odës së Avokatëve), rregullore kjo e cila e ka bazën në ligj, andaj rrjedhimisht do të nënkuptonte edhe shkeljen e ligjit.

Ju po ashtu jeni i papërgjegjshëm, për arsye se Formularin e Tenderit nuk e keni plotësuar në mënyrë të drejtë pasi që validiteti i ofertës është 120 ditë – vlerë e madhe (shërbim), ndërsa ju e keni paraqitur 90 ditë që është në kundërshtim me Rregulloren e Prokurimit Publik, Neni 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur, AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së.

Mungon licenca	Mund të kërket informata shtesë	66
Mungon certifikate ISO	Mund të kërket informata shtesë	69
Mungon çmimi	Refuzo tendera pa kërkuar informata të mëtejshme	Kusht administrativ
CV-ja e dorëzuar nuk përmban lëvizjet	Refuzo tendera pa kërkuar informata të mëtejshme	69
CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund të kërket informata shtesë	69
CV-ja e dorëzuar nuk përmban informata të kërkuara, AK nuk mund të vendosë	Mund të kërket informata shtesë	69
Mungon shërbimi në gjendje ekonomike dhe financiare	Mund të kërket informata shtesë	68

Thërrisni në gjendje ekonomike dhe financiare nuk përmban lëvizjet manuale	Refuzo tendera pa kërkuar informata të mëtejshme	68
Thërrisni në gjendje ekonomike dhe financiare nuk përmban lëvizjet manuale	Refuzo tendera pa kërkuar informata të mëtejshme	Kusht administrativ
Lista e çmimeve është plotësuar por nuk është nënshkruar (tendëri e dorëzuar në formë fizike)	Refuzo tendera pa kërkuar informata të mëtejshme	Kusht administrativ
Sigurimi i Tenderit mungon sipas kërkesës së përcaktuar sipas formës standarde të DT	Refuzo tendera pa kërkuar informata të mëtejshme	57
Lista e çmimeve nuk është plotësuar	Refuzo tendera pa kërkuar informata të mëtejshme	Kusht administrativ
Mungon deklarata e qortë ku të gjatë mëtarët e grupit janë bashkëpunues dhe individues	Refuzo tendera pa kërkuar informata të mëtejshme	Kusht administrativ

Pretendimi që i referoheni për “konflikt interesi” është komplet i pabazuar, dhe nuk është në diskrecion të

Autoritetit Kontraktues të vlerësojë pretendimin tuaj.

Ndërsa, sa i përket pretendimit për shtatë vite përvojë pune profesionale juridike, e njëjta nga OE fitues është plotësuar për faktin që nga dëshmitë e ofruara i njëjti ka më shumë se 10 vite përvojë punë profesionale e juridike dhe rrjedhimisht është interpretim i gabuar i kriterit që duhet të ketë 7 vite përvojë. Të gjitha pretendimet e tjera në lidhje me operatorin e rekomanduar për kontratë janë të pabazuara. Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë ka kontratë valide për shërbime juridike konform kërkesës së dosjes së tenderit .

Po ashtu, pas shqyrtimit të dokumentacionit tuaj, kemi vërejtur se njëri nga avokatët e operatorëve ekonomik, përkatësisht përfaqësuesi z.Arber Fazliu në cilësi të avokatit ka përfaqësuar palë në procedura gjyqësore ku komuna e Drenasit ka qenë palë në procedurë të qenurit palë përkatësisht përfaqësues i palës në procedurë është në kundërshtim me kriterin “Kapaciteti teknik dhe profesional”, sipas të cilit kërkesa 4 thekson se “Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj Deklaratë me shkrim që nuk ka qenë palë paditëse apo e paditur kundër komunës në 5 vitet e fundit, andaj përmes deklaratës ku theksoni se nuk keni qenë palë në kontestet e tilla, ju keni deklaruar rrejshëm dhe rrjedhimisht keni tentuar ta vëni në lajthitje autoritetin kontraktues, përkatësisht komunën e Drenasit.

Kundër këtij vendimi keni të drejtë ankesë në OSHP në afat prej 10 ditë.